



LAJME nga FONDACIONI  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË  
Tiranë

N.19  
Korrik-Gusht  
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"  
Kompleksi Spitalor Universitar  
"Zoja e Këshillit të Mirë"  
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm  
unikzkm  
www.unizkm.al  
pr@fzkm.org

# NJË MJET EDUKATIV DHE KULTUROR PËR TË LUFTUAR URREJTJEN



**Kopshtet e të Drejtëve: vendi  
ku kultivohet dinjitetin njerëzor**

nga Joshua Evangelista  
*Përgjegjës për komunikimin i Gariwo*



Më 18 qershor u mbajt edicioni i katërt i Ditës Ndërkombëtare Kundër Urrejtjes, e shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2021. Edhe Fondacioni Gariwo është një shembull i praktikës së mirë për ndërtimin e koalicionëve etike kundër gjuhës së urrejtjes. Gariwo do të thotë «Gardens of the Righteous worldwide» dhe është një organizatë e themeluar në vitin 1999 në Milano.

**Kopshti i parë u themelua në vitin 2003 në Milano, ndërsa ai i Tiranës, i vetmi në Shqipëri në vitin 2024.**

Në vitin 2012 Fondacioni Gariwo mori nga Parlamenti Evropian miratimin për caktimin e Ditës së të Drejtëve, e cila festohet çdo vit më datë 6 mars. Fondacioni Gariwo ka qenë një nga mysafirët specialë të Kombeve të Bashkuara për Ditën Ndërkombëtare Kundër Gjuhës së Urrejtjes, ku u prezantua modeli i Kopshteve të të Drejtëve si një mjet edukativ, kulturor dhe qytetar për të luftuar urrejtjen dhe për të parandaluar mizoritë e reja. Në qendër të këtij takimi ishte propozimi për të krijuar një Ditë Ndërkombëtare të të Drejtëve të Njerëzimit duke njohur zyrtarisht vlerën universale të atyre që

në çdo kohë dhe në çdo vend kanë mbrojtur dinjitetin njerëzor duke u kundërvënë krimeve, përndjekjeve dhe regjimeve autoritare. Kontributi i Gariwos në këto vite është njohur: është koha të bëjmë përpjekje për dinjitetin e të gjithëve edhe në këto kohë lufte.

Një nga momentet më domethënëse ishte fjalimi i përfaqësuesve të fshatit dykombësh Neve Shalom – Wahat al-Salam, Nir Sharon dhe Samah Salaime, të cilët përshkruan jetën e përditshme në një vend unik ku familjet hebreje dhe ato palestineze kanë zgjedhur të jetojnë së bashku në emër të paqes dhe kundër dhunës. Dëshmia e tyre preku thellë audiencën. Lufta që po zhvillohet ka goditur edhe këtë eksperiencë të brishtë të bashkëjetesës.

Sot fshati është i ndarë dhe Samah është bllokuar në Paris në pamundësi të kthehet në Izrael dhe e pasigurt se kur do të mund të përqafojë përsëri komunitetin



e saj. Në këtë kontekst Kopshti i të Drejtëve në Neve Shalom – Wahat al-Salam merr një vlerë edhe më të fuqishme, jo vetëm si një hapësirë kujtese, por edhe si një gjurmë e gjallë e një dialogu të mundshëm që sot është pezulluar.

**Të drejtët janë kujdestarët e njerëzimit, tha Gabriele Nissim, president i Gariwo. « Nuk mund të kufizohemi vetëm në kujtimin e viktimave kur është tepër vonë por duhet të edukojmë për të parandaluar dhe ta bëjmë këtë duke treguar historinë e atyre që patën guximin të zgjidhnin përhapjen e së Mirës përpara së keqes.**

Ky është kuptimi i thelluar i Kopshteve të promovuara nga Gariwo në mbi 300 qytete të botës: jo monumente, por hapësira qytetare ku kujtimi i së Mirës kultivohet

si bazë për një qytetari të përgjegjshme, të hapur dhe solidarë. Jo thjesht vende të kujtesës pasive, por aktivizëm etik ku historia ndërthuret me edukimin, pjesëmarrjen dhe njohjen publike të atyre që kanë zgjedhur të mos e kthejnë shpinën shpesh edhe në vetmi. Nisma e paraqitur në Nju Jork synon tani të përfshijë një grup vendesh për të mbështetur një mocion në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për njohjen zyrtare të Ditës së të Drejtëve të Njerëzimit, të përcaktuar tashmë si festë civile në Itali dhe në Republikën e San Marinos dhe të njohur nga Parlamenti Evropian. Disa shtete kanë shprehur interesin për t'u bashkuar. Qëllimi është ndërtimi i një koalicioni ndërkombëtar që vlerëson figurat shembullore të kohës tonë, jo vetëm si trashëgimi etike, por edhe si mjete aktive për parandalimin, edukimin dhe diplomacinë kulturore. Në një epokë të shënuar nga luftëra të reja ku përshkallëzimi i retorikës së dhunës dhe kriza e thellë e bashkëjetesës kërcënohet, të Drejtët na kujtojnë se një alternativë është gjithmonë e mundur.

Edhe në zemër të një konflikti në dukje të papajtueshëm, siç është ai midis izraelitëve dhe palestinezëve mund të ndërtohet një kopsht në të cilin mund të mbillet dhe të ndahet kujtimi i atyre që zgjodhën paqen.

# KAMPUSI RIKTHEHET NË ZGJEDHJE

I drejti 2026

Në vjeshtë stafi i UKZKM do të nisë përgatitjet për procesin e zgjedhjeve të reja për Të Drejtin e vitit 2026. Ky është një nga angazhimet më të bukura nën kujdesin e Presidentit të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. **Ruggero Valentini**, i cili bashkon në një iniciativë qytetare një komunitet të madh studentësh, pedagogësh, staf mbështetës dhe akademik, miq dhe bashkëpunëtorë të Zojës së Këshillit të Mirë në Tiranë.

Në Mars 2026 do të kurorëzojmë për të tretin vit rradhazi shpalljen e Të Drejtë, emri i të cilit do të vendoset në Kopshtin e Të Drejtëve në Kampusin Spitalor dhe Universitar ZKM që tashmë është i vizitueshëm nga të gjithë dhe ka nisur të bëjë jehonë edhe në rrjetet ndërkombëtare. Ky kopsht është i vetmi në Shqipëri dhe u ndërtua në vitin 2024 me rastin e 20 vjetorit të themelimit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", tashmë pjesë e rrjetit ndërkombëtar "Gariwo" të Milanos (Gardens of the Rightous Worldwide). Në hapësirën urbane të kopshtit në gurët

e vendosur brenda tij janë gdhendur emrat e dy personaliteteve **Carlo Urbani** dhe **Ibrahim Rugova**, si njerëz që u vlerësuan për kontributet që dhanë në shërbim të komuniteteve dhe njerëzimit në kohë të vështira duke dhënë shembullin personal. Për herë të parë gjatë vitit 2025 në Kampusin e UKZKM u organizua votimi i fshehtë, pjesë e të cilit u bënë studentë, profesorë dhe të ftuar, Përmes kësaj iniciative Fondacioni ZKM synon të promovojë mes studentëve, punonjësve dhe të ftuarve dimensionin shpirtëror të jetës, qytetarinë aktive dhe ndjeshmërinë ndaj të mirës së përbashkët.

Kopshti i të Drejtëve është një hapësirë shpirtërore, takimesh dhe përkujdesje ndaj marrëdhënieve njerëzore.

Në foto,  
**Dr. Simona Cruciani**,  
Përgjegjëse për Çështjet  
Politike në Zyrën e  
Kombeve të Bashkuara  
për Parandalimin  
e Gjenocidit, gjatë votimit  
për të zgjedhur të Drejtin  
2025.



# *Pushimet në Shqipëri*

**Për shëndetin tuaj kujdeset Spitali Katolik dhe Poliambulanca**

Nëse je në Shqipëri për pushime dhe të duhet ndihmë mjekësore, e ke një zgjidhje të shpejtë dhe efikase, Spitali Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe Poliklinika Atë Luigji Monti në “Rrugën e Kavajës”.

**Të dyja strukturat poliambulatore dhe spitalore ndodhen në afërsi të qendrës së Tiranës dhe janë lehtësisht të arritshme për këdo.**

Turistë të huaj apo vendas që nuk jetojnë në Tiranë mund të mbështeten lehtësisht tek strukturat tona shëndetësore për të mbrojtur dhe ruajtur shëndetin gjatë kohës së qëndrimit në kryeqytetin shqiptar. Spitali Universitar Katolik është sot në Shqipëri një nga strukturat më modern, me staf mjekësor



profesional me formim akademik dhe eksperiencë në bashkëpunim me institucionet më të rëndësishme mjekësore Evropiane. Spitali jep shërbime në diagnostikimin dhe trajtimin e specialiteteve në Kirurgji, Sëmundje të Brendshme, Imazheri, Analiza Laboratorike. Po kështu edhe **Poliambulanca Atë Luigji Monti** ka staf të specializuar mjekësor shqiptaro-italian dhe punon me aparatura të teknologjisë së fundit. Strukturat tona shëndetësore ndërthurin shërbimet për një diagnozë sa më të plotë dhe të saktë për të gjithë pacientët.

## **MBYLLJA E NJË VITI AKADEMIK NË UKZKM**

**Krenari dhe sukses në  
përfundim  
të vitit akademik**

Mbyllja me sukses e një viti akademik sjell gëzim dhe lehtësim tek studentët që ndërsa shtojnë njohuritë profesionale i afrohen diplomimit.

Çdo vit në Kampusin tonë Universitar dhe Spitalor “Zoja e Këshillit të Mirë” jemi dëshmitarë të përpjekjeve që bëjnë studentët tanë për të kapërcyer sfidën e provimeve të fundvitit, duke marrë vlerësimin sipas meritës për aftësitë e treguara në programet tona të studimit.





Suksesi i tyre është edhe sukses i punës së palodhur dhe të çertifikuar ndërkombëtarisht të trupës tonë akademike që garanton edukimin me standardet evropiane dhe marrjen e diplomave njësoj sin ë vendet e Bashkimit Evropian.

Ndaj në fund të çdo viti jo vetëm ju urojmë suksese, por edhe shprehim krenarinë për arritjet tuaja që janë prova më e mirë e cilësisë së studimeve në UKZKM.

## ÇFARË NA MËSON HISTORIA E LUIGJI MONTIT DHE SHOKËVE TË TIJ

Të rinjtë, besimi  
dhe vëllazëria:  
tregimi i një misioni  
shprese në ritmin  
e jetës



**nga Fr. Ruggero Valentini**

President / Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë  
Tiranë

**E** kam shkruar këtë rrëfim të shkurtër duke menduar për të rinjtë, shoqëruesit e mi në një ndryshim të trazuar epoke. Si edukator, më prek së brendshmi tema e pranisë së brezave të rinj në jetën sociale. Një temë që ka pasoja të dukshme mbi fenë, shkollën, sportin, vullnetarizmin, kulturën dhe familjen ...

Për të bashkuar vëllazërinë me protagonizmin rinor jam udhëhequr nga figura e Luigji Monti-t, i cili ka qenë infermier dhe edukator edhe pse ndoshta njihet vetëm si themelues i një kongregacioni fetar. Të mendosh për të rinjtë së bashku me ta është mënyra e duhur për të mos instrumentalizuar kontributin e tyre në inovacion. E ardhmja e tyre ndryshon gjithmonë nga e tashmja dhe nga ana tjetër nuk është as fotokopje e së shkuarës. Në këtë mënyrë ndërsa shikojmë se nga anojnë dëshirat dhe projektet e tyre mund të ndajmë në mënyrë të dobishme me brezin e ri disa fragmente të historisë që rrëfej në këtë libër.

A krijon rritja e besimit tek të rinjtë aftësi për një jetë të lumtur dhe bujare? A na

ndihmojnë ato të shfrytëzojnë mundësitë e kësaj kohe? Si i japin dikujt këto përvoja transversale shansin të marrë pjesë me sukses në procese inovative duke u përballur me sfidat e jetës dhe kërkimit shpirtëror?

Vëllazëria është e Bukur (*Fratello è Bello*) karakterizohet nga zhanri i tij rrëfimtari, lajtmotivi i vëllazërisë, apeli ndaj protagonizmit të të rinjve, thirrja si një dimension i jetës.

**Ka uri për histori që frymëzojnë të rinjtë dhe jo vetëm, një uri që shpesh plotësohet me tregime artificiale dhe promovuese. Ndërkohë që “një histori e mirë është në gjendje të kalojë kufijtë e hapësirës dhe kohës” dhe “duke u zhytur në histori, mund të gjejmë motivime heroike për të përballuar sfidat e jetës”**

**(Papa Françesku).**

Tema e dytë, vëllazëria, e cila gjendet në titullin e librit është bërë një lajtmotiv që duhet të përshkojë jetën e brendshme të Kishës dhe të ushqejë marrëdhëniet e saj me botën e jashtme (shih Dokumentin për vëllazërinë njerëzore, nënshkruar nga Papa Françesku në Abu Dhabi në 2019, deri te letra e tij enciklikë “*Jemi vëllezër të gjithë*” e vitit 2020).

Protagonizmi i të rinjve, tema e tretë, përfaqëson një nga pikat kryesore të kthesës në pastoralin rinor, i cili në Kishë duket se ka humbur shtytjen e tij nxitëse.

Ngjarja nga e cila merr shkas ky libër është pikërisht kjo qasje që përfshin një grup të rinjsh besimtarë që promovojnë forma të reja të bashkimit, të mbështetura dhe sfiduara nga ana e klerit.

Së fundi, tema e dimensionit të vokacionit për jetën. Nuk bëhet fjalë vetëm për të rritur thirrjet drejt shërbimit priftëror. Ndjehet gjithnjë e më shumë nevoja për thirrje laike dhe thirrje të shuguruara që të japin dëshmi të një vëllazërie. Vëllazëria është e Bukur sepse është një mision kishtar dhe qytetar: të krishterët takohen me të gjithë për të ndërtuar së bashku një botë ku të jetë e mundur vëllazëria.

Le të rrëfejme këtë histori me ritmin e muzikës, të kërcimit, të këngës, sepse jeta është si një partiturë ku ritmi mund të të ngadaltojë ose i gjallë, i gëzuar ose i trishtuar, shprehje e një soloisti apo e një kori që gjithmonë ka një kuptim, kuptimin e jetës që na bën vëllezër. Të gjithëve!



# ANATOMAGE: ANATOMIA 3D QË REVOLUCIONARIZON FORMIMIN MJEKËSOR

**Teknologji moderne për një mësim realist dhe ndërveprues sipas standardeve evropiane**

Investimet në teknologjinë e fundit janë pjesë e pandarë e infrastrukturës arsimore në UKZKM me qëllim rritjen cilësore profesionale dhe akademike të studentëve tanë. I tillë është "Anatomage" sistemi më i përparuar i anatomisë 3D të trupit të njeriut që shërben për arsimimin mjekësor.

Aparatura është pjesë e programit mësimor për të rinjtë që ndjekin studimet në UKZKM dhe jep një pamje mbresëlënëse, të imtësishme të trupit të njeriut në të gjitha dimensionet pamore, deri në ndërtimin më të imët anatomik të trupit njerëzor.

Kjo aparaturë shërben si platformë mësimore e digjitalizuar duke u dhënë mjete të jashtëzakonshme studentëve që marrin të dhëna të vlefshme në aspektin mjekësor duke vëzhguar në mënyrë reale anatominë 3D.

Kjo aparaturë ka revolucionarizuar mësimin në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" duke rritur vlerën e programeve të studimit dhe duke siguruar prditësimin e mësimave në fushën e mjekësisë sipas standardeve evropiane.



Paisja "Anatomage" përmirëson rezultatet e të mësuarit duke e bërë reale anatominë e njeriut, aq e nevojshme për studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe jo vetëm duke krijuar që në fillesat e studimeve sukses për talentet në mjekësi.

## AT' MONTI KRIJON NJË KOMUNITET INFERMIERËSH

nga Fr. Ruggero Valentini

President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë  
Tiranë

Rrënjët  
e përkujdesjes



Sot ndalemi tek një aspekt i dëshmisë montiane që nuk është trajtuar mjaftueshëm. Më shumë në kuptimin e tij etik dhe ekzistencial, në mos edhe teologjik sesa në atë historik. Mund ta nisim me një pyetje: cilat ishin sfidat që Kisha duhej të përballonte në momentin e themelimit të Kongregatës së Bijve të Zojës së Papërlyer, e cila lindi në Romë në vitin 1857 në spitalin Santo Spirito në Sassia? I referohem Kishës sepse aty ishte horizonti në të cilin shihte Luigji Monti.

Në mes të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Italia ishte ende e ndarë në shumë shtete dhe te Luigji Monti nuk dominonte aspak motivimi me natyrë kombëtare. Nuk ishin sfida të lidhura domosdoshmërisht me çështjet e shëndetësisë: Papati po përjetonte një delegjitimim politik, me rritjen e nacionalizmit dhe zgjerimin e Mbretërisë Italiane nga Piemonte deri në Sicili. Papa, i provokuar nga rryma mendimi sekularizuese dhe prirje laike, ishte rikthyer të pohonte pushtetin e tij civil në Shtetin Papnor dhe atë fetar me shpalljen e pagabueshmërisë së Papës.

Megjithatë, vitet pesëdhjetë të shekullit XIX ishin të trazura edhe për sa i përket botës së shëndetësisë. Florence Nightingale e vuri në jetë intuitën e saj për të themeluar profesionin e infermierisë mbi baza më rigoroze dhe më të gjera arsimore.

Henry Dunant, në vitin 1859, një ditë pas betejës së Solferinos në Lombardi u gjend përballë “një prej pamjeve më të tmerrshme që mund të imagjinohej”: një masakër që la 40 mijë burra të vdekur dhe të plagosur në fushëbetejë. Dhe kështu vendosi të promovojë Kryqin e Kuq.

Si për Nightingale ashtu edhe për Dunant shtysa për të vepruar erdhi në një kontekst me natyrë luftarake. Në fakt lufta solli pamjen dramatike të të plagosurve, me shumë pak kujdes dhe të braktisur. (Giorgio Cosmacini...)

Në ato vite, Luigji Monti së bashku me Cipriano Pezzini shkuan në Romë për të themeluar një komunitet fetarësh të përkushtuar si infermierë ndaj kujdesit për të sëmurët. Zgjedhja për të promovuar figurën e infermierit përmes jetës vëllazërore në komunitetet e burrave të shuguruar mund të duket pak origjinale.

Të tilla ishin kohët: vetë Nightingale kishte hequr dorë nga martesë për t’iu përkushtuar botës së shëndetësisë dhe vajzat që ajo përgatiste për këtë profesion duhej të kishin një frymë të fortë fetare madje duke jetuar së bashku pranë spitalit.

**Luigji Monti themeloi këtë Komunitet vëllazërisht infermierë pas përvojave të mëparshme që e kishin motivuar fort, si ajo në Brescia në vitin 1855 kur u mbyll në spital për të ndihmuar pacientët me kolerë.**

**Shekulli i nëntëmbëdhjetë njihet gjithashtu si shekulli i bamirësisë, siç njihet edhe nga veprat e panumërta që u bënë për të ndihmuar të sëmurët, emigrantët, jetimët, të burgosurit, gratë e marginalizuara, punëtorët e rinj,**

## **të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara...**

Duke u nisur nga ky profil, i bekuari Luigji Monti sot mund të shpallet mbrojtësi i të ashtuquajturve “punonjës socio-shëndetësorë” për të cilët mungesa ndihet në çdo vend, në spitale, azile pleqsh, qendra rehabilitimi dhe shërbime në shtëpi.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe më tej vëllazërit e Atë Montit kryen këtë mision në spitale të vogla provinciale dhe në aktivitete në shtëpi gjë që i bëri shumë të njohur.



Ata dhanë kontribut për një periudhë të gjatë shërbimi në kujdesin shëndetësor.

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë, bashkë me Universitetin dhe Spitalin Katolik janë bija të kësaj historie dyqindvjeçare, një histori që na përfshin të gjithëve.

# GJALLËROJMË EVROPËN ME KULTURË

Federata e  
Universiteteve  
Katolike Evropiane  
(FUCE)

**E**lena Beccalli u zgjodh Presidente e Federatës së Universiteteve Katolike Evropiane seksioni evropian i "International Federation of Catholic Universities" më 6 qershor në Leuven (Belgjikë).

Ajo do të udhëheqë rrjetin akademik që bashkon 62 universitete katolike nga të cilat 56 janë të pranishme në 17 vende evropiane dhe 6 në Liban. Beccalli zëvendëson Profesor Michael Mullaney Presidentin e Saint Patrick's College di Maynooth në Irlandë.



**Zonja është italianja e parë dhe gjithashtu gruaja e parë që mban këtë pozicion që do të zgjasë tre vjet.** FUCE u themelua në vitin 1991 me seli në Francë në Universitetin Katolik të Lionit dhe është një pikë referimi e rëndësishme për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në kontekstin arsimor evropian dhe ndërkombëtar.

Prof. Beccalli në programin e saj strategjik ka treguar disa prioritete për të konsoliduar praninë e FUCE në Evropë dhe në botë. Ndër këto forcimi i partneriteteve dhe aleancave strategjike midis Universiteteve Katolike Evropiane; promovimi i programeve të studimit të dyfishta; krijimi i programeve të mobilitetit për pedagogët, kërkuesit e rinj shkencor dhe stafin tekniko-administrativ; zhvillimi i programeve të përbashkëta kërkimore, propozimi periodik i projekteve të përqendruara në çështjet kryesore të kohëve tona. Qëllimi është të sigurohet që universitetet katolike të kenë zërin e tyre aktiv dhe të kontribuojnë në mënyrë efektive në ringjalljen e identitetit evropian dhe rrënjëve të tij. Kjo do të riafirmojë rolin qendror të arsimit dhe kulturës, të cilat kanë qenë gjithmonë gurët themelorë të qytetërimit evropian. Sipas Beccalli-t, ky proces i bazuar në dialog dhe vlerësimin e diversitetit mes universiteteve të Federatës mund t'i japë shtysë projekteve që sjellin përfitime të brendshme për këtë strukturë, por edhe përfitime të jashtme për institucionet dhe shoqërinë.

**Nëse njihen dhe mbështeten në mënyrë të përshtatshme brenda politikave të BE-së universitetet katolike mund ta forcojnë idenë e Evropës dhe të kontribuojnë**

**në realizimin e saj konkret duke rikthyer shpirtin e Unionit», thotë presidentja e re e FUCE.**

Elena Beccalli që nga korriku i vitit 2024 është Rektore e Universitetit Katolik Sacro Cuore' në Milano – universiteti më i madh katolik në botë, me seli në Romë. Ajo është profesoreshë e Ekonomisë së Ndërmjetësve Financiarë në Fakultetin e Shkencave Bankare, Financiare dhe të Sigurimeve ku ka shërbyer si dekane për një dekadë. Krahas roleve të rëndësishme ndërkombëtare ajo është drejtoreshë e Qendrës Kërkimore për Kredinë Bashkëpunuese në Universitetin Katolik Sacro Cuore.

Ka qenë kryetare e seksionit italian të Shoqatës Evropiane për të Drejtën Bankare dhe Financiare (AEDBF) dhe anëtare e bordit drejtues të Akademisë Italiane të Ekonomisë së Biznesit (AIDEA) dhe bashkë-kryetare e European Financial Management Association. Ajo është

bashkëredaktore e Journal of Financial Management, Markets and Institutions. Beccalli u emërua nga Papa Françesku si konsulente në Dikasterin për Kulturë dhe Arsimit dhe ishte senior expert e Villaggio "Finance and Humanity" në kuadër të The Economy of Francesco.

Ajo u kujdes gjithashtu për hartimin e dokumentit



Mensuram Bonam. Profesoresha është autore e shumë artikujve dhe monografive në revista dhe botime të njohura ndërkombëtarisht. Fushat e saj kryesore të interesit shkencor kanë të bëjnë me sektorin bankar të analizuar nga perspektiva e organizimit industrial, me vëmendje të veçantë në çështjet e teknologjisë, efikasitetit, bashkëpunimit, biodiversitetit financiar.

Vitet e fundit studimet e saj janë përqendruar në çështjet e etikës dhe përfshirjes, qëndrueshmërisë dhe bashkëpunimit, inteligjencës artificiale dhe lidershitit femëror. Urimet më të përzemërta për Prof. Beccalli-n, pjesë e komunitetit tonë universitar.

# UNIVERSITETET: KUR KULTURA KRIJON LIDHJE



**Studenti protagonistë në Europë: katër ditë rritjeje  
akademike dhe kulturore**

**N**ga data 27 deri më 30 maj 2025 studentët e Ekonomisë dhe Programit Master të shoqëruar nga **Prof. Asoc. Klodian Muco, PhD Blerina Meta dhe PhD Bardhe Karra** morën pjesë në workshopin Evropian "Shkolla Verore Hyrëse" dhe workshopin e XV NERI me titull "Ofrimi i Shërbimeve Publike Lokale dhe Cilësia e Institucioneve", të organizuar nga **Departamenti i Ekonomisë i Universitetit të Chieti-Pescara G. D'Annunzio**.

Gjatë katër ditëve studentë dhe pedagogë nga vende të ndryshme përfshirë Bosnje-Hercegovinën, Shqipërinë dhe Italinë morën pjesë aktive në seminare, prezantime punimesh, diskutime dhe aktivitete praktike duke përfutur një përvojë të ndryshme akademike.

**Kjo ishte një mundësi e vërtetë për shkëmbim kulturor dhe krahasim ndërkombëtar me studentë dhe mësues nga universitete të tjera, gjë që u lejoi pjesëmarrësve të përjetonin nga afër vlerën e lëvizshmërisë akademike: largimin**

**nga klasa, udhëtimin, takimin me realitete të reja dhe njohjen me çështje globale.**

Iniciativa është pjesë e projektit TNE-DeSK (Zhvillimi i Njohurive të Përbashkëta në Materialet Inovative dhe Transformimin Dixhital për Ekonomi të Qëndrueshme dhe Tranzicion të Gjellbër), i cili promovon lëvizshmërinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin akademik midis 10 universiteteve italiane dhe 68 universiteteve ndërkombëtare nga Amerika Latine, Ballkani përfshirë Turqinë dhe UKZKM.

Përmes shkëmbimeve, kërkimit dhe trajnimit, projekti synon të zhvillojë aftësi mbi inovacionin, qëndrueshmërinë dhe transformimin dixhital. Iniciativa ka inkurajuar dialogun midis institucioneve universitare mbi çështjet kryesore për zhvillimin e aktiviteteve të ardhshme.

Një mundësi për studentët tanë për të përjetuar dimensionin evropian të universitetit, për të forcuar aftësitë transversale dhe për të ndërtuar rrjete profesionale përtej kufijve. Dhe universiteti ynë vazhdon të investojë në këto mundësi.

## KRYQËZIME: TIRANË-VALENCIA-BUKURESHT

Erasmus +



**N**ga 19 deri më 23 maj Prof. Antonella Biscione zhvilloi një vizitë studimore në **Universitetin Katolik San Vicente Mártir në Valencia**, në kuadër të Programit Erasmus+.

Gjatë vizitës së saj ajo mori pjesë në seminare mbi inovacionin dhe eko-inovacionin, në të cilin ishin pjesë edhe studentë të Ekonomisë dhe staf akademik si nga institucioni pritës ashtu edhe nga Akademia e Studimeve Ekonomike e Bukureshtit.

Përvoja ofroi një mundësi të dobishme për të shkëmbyer ide mbi tranzicionet e gjelbra dhe dixhitale në Evropë për të promovuar dialogun ndërdisiplinor dhe për të forcuar bashkëpunimin akademik ndërkombëtar.

# SPECIALIZIMET. OBJEKTIVAT U ARRITËN

Në Aula Magna në UKZKM u mbajtën sot provimet përfundimtare të programeve të studimit në specializimet e **Gastroenterologjisë, Sëmundjeve kardiovaskulare, Anestezi, Reanimacion dhe Terapi Intesive, Gjinekologji dhe Obstetri.**



Studentët diskutuan me trupën e profesorëve të UKZKM tezat e tyre rreth specializimeve të ndjekura gjatë viteve akademike në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

## BËHU PROFESIONIST PËR NJË DITË!



### *Të dashur maturantë!*

Provimet përfunduan dhe tani do të nisni një rrugëtim të ri, të shumëpritur prej jush, studimin universitar.

Duke konsoliduar traditën e edukimit cilësor që njihet ndërkombëtarisht Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ju ofron mundësi të shumta për jetën tuaj akademike. Suksesi arrihet vetëm me përkushtim ndaj duke na vizituar në Kampusin Universitar, duke biseduar me profesorë dhe koordinatorë, zgjedhja juaj do të jetë më e thjeshtë.

Ndiqui rrjetet tona sociale, qëndroni në kontakt me sekretaritet tona gjatë verës për të mësuar më shumë rreth programeve tona të studimit.

UKZKM ofron në të gjitha dimensionet një potencial të vërtetë të një kampusi universitar evropian.

**Eja në UKZKM!**

**Studio si në Evropë!**

**Diplomë e dyfishtë dhe e njohur ndërkombëtarisht!**

# SHKËMBIME UNIVERSITARE

Nuove prospettive per la mobilità e la formazione

Gjatë dy javëve të fundit të qershorit, patëm kënaqësinë të mirëpresim në Universitetin tonë stafin e Zyrave për Mobilitet Ndërkombëtar dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Universitetit të Urbinos "Carlo Bo" (Itali), L. Bartolucci, si dhe atë të Universitetit Katolik të Ružomberokut (Sllovaki), M. Pinkoš dhe L. Kravčáková, në kuadër të një mobiliteti për formim Erasmus+ KA171.

Gjatë takimeve me **Zyrën tonë të Projekteve Formuese dhe Kërkimit Shkencor si dhe me stafin e Fakulteteve**, u ndanë qasje dhe praktika të mira në menaxhimin e mobiliteteve ndërkombëtare, me fokus të veçantë te procedurat administrative dhe mjetet operacionale, te koordinimi ndërmjet institucioneve partnere për mobilitetin jashtë BE-së, te promovimi i mobilitetit hyrës dhe dalës, te zhvillimi i projekteve të përbashkëta dhe te forcimi i bashkëpunimit dypalësh.



Këto momente dialogu ndërmjet zyrave përbëjnë një burim të çmuar për të ndërtuar një bashkëpunim ndërkombëtar gjithnjë e më të fortë, efikas dhe të orientuar drejt cilësisë. Ndërkohë është konfirmuar një projekt i ri Erasmus+ për trevjeçarën e ardhshme me **Universitetin e Urbinos "Carlo Bo", i cili do të përfshijë në mënyrë të strukturuar Fakultetin e Ekonomisë dhe atë të Farmacisë**, duke ofruar mundësi të mëtejshme mobiliteti dhe shkëmbimi për studentët dhe pedagogët, ndërkohë jemi në pritje të rezultateve për universitete të tjera.



## MIQTË NGA SLLOVAKIA

Si pjesë e programit Erasmus+ Teaching Mobility patëm kënaqësinë të prisim tre profesorë nga Universiteti Katolik i Ružomberok (Sllovaki) gjatë javës **2-5 qershor 2025**, të cilët mbajtën një seri leksionesh dhe shkëmbimesh akademike me studentë dhe profesorë nga fushat e fizioterapisë dhe infermierisë.

Peter Kutiš ndau teknika inovative rehabilitimi në kirurgjinë ortopedike pas operacionit.



Soňa Hlinkova ofroi njohuri praktike mbi parandalimin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor.

Lukáš Kober nxiti një reflektim mbi rolet e avancuara dhe cilësinë në kujdesin infermior.

Leksionet ngjallën interes të madh me pjesëmarrje të gjerë nga studentët dhe dialogje të gjalla që pasuruan përvojën e trajnimit.

Një moment shkëmbimi të vërtetë ndërkombëtar që la një ndikim pozitiv në të gjithë komunitetin akademik.

# DREJT NJË PAKTI TË RI PËR MESDHEUN

Universitete të  
lidhura në rrjet  
për të ardhmen  
e Mesdheut

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" i përfaqësuar nga Delegatja e Rektorit për "Marrëdhëniet me Universitetet dhe Renditjet" Prof. Angela Andreoli u bë pjesë e Asamblesë së Përgjithshme të UNIMED që u mbajt më datë 9 dhe 10 Korrik 2025 në Cosenza të Italisë. Takimi u zhvillua në Universitetin e Kalabrisë (UNICAL) nën kujdesin e Parlamentit Evropian dhe Unionit për Mesdheun si dhe Ministrisë së Jashtme Italiane. Aktiviteti dyditor mbledhi rreth 200 pjesëmarrës anëtarë të UNIMED dhe partnerë institucionalë.

Asambleja e Përgjithshme u përshëndet edhe nga Nicola Leone Rektori i Universitetit të Kalabrisë, nga Kheried Rassas Presidenti i UNIMED, nga Hmaid Ben Aziza, Sekretari i Përgjithshëm i UNIMED dhe nga Roberto Occhiuto Presidenti i Rajonit të Kalabrisë.

Gjithashtu në këtë takim mori pjesë Romano Prodi në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Evropian për Mesdheun.

Gjatë këtij takimi vjetor rektorët, presidentët dhe përfaqësuesit e UNIMED ndanë ide dhe propozime për të përcaktuar politikat e ardhshme të këtij organizmi duke hedhur themelet për një vit të ri plot iniciativë, aktivitete dhe konferenca që do të ndikojnë në peizazhin akademik në Mesdhe dhe në Ballkan.

Asambleja UNIMED e vitit 2025 ka një rëndësi të veçantë për promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit falë disa faktorëve kryesorë:

30-vjetori i Procesit të Barcelonës i vitit 1995, i cili vendosi një kornizë të re për bashkëpunimin euro-mesdhetar duke sjellë rezultate të shumta. Rikthim i vëmendjes nga Komisioni Evropian, i cili po mbështet rëndësinë e



marrëdhënieve euro-mesdhetare duke emëruar një Komisioner për Mesdheun dhe duke nisur një proces konsultimi për përpilimin e një 'Pakti të ri për Mesdheun', miratimi i të cilit pritet këtë vjeshtë.

Përballja e krizave rajonale, duke pasur parasysh krizat e shumta që prekin rajonin tonë, ndaj institucionet e arsimit të lartë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre për të mbështetur studiuesit dhe refugjatët në rrezik.

**Forcimi i bashkëpunimit mes universiteteve duhet të sjellë edhe bashkëpunimin me autoritetet rajonale dhe fondacionet e ndryshme për të përmirësuar bashkëpunimin mes komunitetit akademik, organeve lokale dhe shoqërisë civile.**

**Përshtatja me Inteligjencën Artificiale, rritja e prezencës së kësaj platforme në shoqëritë tona kërkon që sistemet universitare të rishikojnë proceset e tyre arsimore dhe të zhvillojnë një kuadër referimi të fortë dhe modern për arsimin e lartë. Programi i Asamblesë së këtij viti pasqyron këto prioritetë që synojnë rilindjen e partneriteteve euro-mesdhetare në arsimin e lartë.**

Një moment i rëndësishëm i asamblesë ishte nënshkrimi i një "memorandumi mirëkuptimi" midis FAO-s dhe UNIMED-it sepse edhe në këtë takim u shfaq nevoja për të ndihmuar përveç mbrojtjes së klimës dhe përshtatjes me inteligjencën artificiale, edhe me një nga çështjet kryesore që sot është "Siguria Ushqimore". FAO dhe UNIMED marrin një rol të ri në bashkëpunimin për Mesdheun edhe në formën e programeve universitare. Duhet investuar në sigurinë ushqimore dhe në edukimin e brezave të rinj për të rritur dhe forcuar qëndrueshmërinë e popujve.



# REALITETI VIRTUAL: NJË DIMENSION I RI PËR ARKITEKTURËN

Realiteti Virtual (VR) po bën revolucion mbi mënyrën se si përfaqësohet, kuptohet dhe komunikohet arkitektura. Në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në UKZKM, në programin e studimit në Arkitekturë, kjo teknologji ka gjetur një shprehje të plotë në dy evente të fundit të dedikuara për studentët e ardhshëm.

Gjatë "Open Day" më 12 prill 2025 pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë virtualisht mjedise arkitekturore nëpërmjet përdorimit të syzeve VR. Të rinjtë "u zhytën" nëpërmjet përjetimit digjital në hapësirat e projektuara në këto dimensione të posaçme. Një përvojë e ngjashme u përsërit më 27 qershor 2025 në kuadër të iniciativës "Bëhu profesionist për një ditë", duke ofruar një pamje konkrete të punës së arkitektit të së ardhmes. Mundësia për të "ecur" brenda një projekti, përpara se ai të ndërtohet përfaqëson një mjet të fuqishëm formues dhe profesional që nxit krijimtarinë, vetëdijen hapësinore dhe kuptimin teknik.

VR-ja konsiderohet sot një aleat shumë i rëndësishëm në mësimdhënien bashkëkohore të arkitekturës.



nga Ark. Franc Shllaku

Universiteti Katolik  
Zoja e Këshillit të Mirë  
Tiranë

## ËSHTË THEMELUAR KOMISIONI

CESPIC Peace  
Prize First  
Edition 2025

Në opinionin publik spikati thirrja e Papa Leonit XIV për të krijuar 'institucione për paqen'. Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë prej disa vitesh është duke ecur në këtë drejtim duke themeluar CESPIC (Qendra Evropiane për Shkencën e Paqes, Integritimit dhe Bashkëpunimit), e cila funksionon në strukturën e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".



Pas disa muajsh përgatitjeje Bordi i Administrimit të Fondacionit ZKM propozoi krijimin e **Çmimit Vjetor për Paqen**, i cili do të bashkojë kontributet e Qendrës tonë CESPIC dhe Observatorit Ballkan-Kaukaz-Transeuropian.

Për këtë arsye u krijua një Komision ndërkombëtar i përbërë nga disa anëtarë ex-officio si më poshtë:


fr. **Ruggero Valentini** President i Fondacionit ZKM, Prof. **Leonardo Palombi** Rektor i Universitetit Katolik ZKM, Prof. **Raul Caruso** Drejtor i CESPIC dhe **Dr. Luisa Chiodi** Drejtoreshë e Observatorit Ballkan-Kaukaz-Transeuropian.

Komisioni do të ketë në përbërje edhe anëtarë të tjerë si Dr. **Senada Šelo-Šabić** nga Instituti për Zhvillim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Zagrebi (Kroaci); Prof. **Jovan Teokarević** nga Universiteti i Beogradit (Serbi); Prof. **Alessandra Russo** nga Universiteti i Trentos – Shkolla për Studime Ndërkombëtare; Z. **Luigj Mila** Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Justitia et Pax- Albania i propozuar nga Konferenca Ipeshkvnore e Kishës Katolike të Shqipërisë; Prof. **Andi Rembeci** nga Universiteti i Tiranës i propozuar nga Patriarkati Ortodoks i Shqipërisë. Në një rajon të trazuar si Ballkani ku tensionet janë ende të pranishme dhënia e "Çmimit për Paqen" bëhet një mjet i dobishëm për të treguar individë dhe/ose grupe që në komunitetet ku jetojnë nxisin nisma për bashkëjetesë të shëndetshme.

Ky çmim frymëzohet nga perspektiva e një ekologjie integrale, e cila është përshkruar në mënyrë shterruese nga Papa Françesku në dy letrat e tij sociale Laudato si dhe Fratelli tutti. Mjedisi, shoqëria, kultura dhe ekonomia janë sisteme të ndërthurura që krijojnë një ndërvarësi midis kujdesit për natyrën dhe drejtësisë sociale.

# DHURO LIBRAT E FËMIJËRISË

Një iniciativë për të mbështetur dijen!



da Mimoza Agastra

Përgjegjëse e Bibliotekës "Fr. Paolo Ruatti" pranë UKZKM

**Q**ë në nisje ky sllogan mund të tingëllojë si një projekt bashkëpunimi konkret, por në fakt është më shumë se aq. Në një kohë kur teknologjia ka zënë vendin e librit, duket se një nismë e tillë vjen si vegim, pasi fare mirë mund të shfletosh ekranin e të lexosh një mori librash të kategorizuar e të shoqëruar madje edhe me zë apo shoqëruar edhe me atë zhurmën shfletosëse të faqeve të tij, teksa ti lexon (kjo për ata fanatikët e librit fizik).

Ndërsa vitet kalojnë era e teknologjisë duket sikur shpluhëros kujtesën. **Ndalesh e me sytë e mendjes sheh dhe kupton që rritja jote e mbërritja në pikën që ti je, është falë progresit dhe këtyre miqve të shtrenjtë që të kanë dhënë dritë e vision.**

I referohem gjithnjë librave që gjithë jetën do tu shoqërojnë, pasi janë një burim i pazëvendësueshëm dhe i sigurtë. Gjatë gjithë këtij rrugëtimi formues, përveçse keni marrë dije dhe informacion keni lënë edhe një copëz kujtimi mbi to: një shënim, një datë, një citat, një emër, një dedikim, aty-këtu ndonjë nënvizim.

Pra, keni gdhendur një moment tuajin, keni investuar ndjesitë e asaj kohe që për sot janë një dëshmi historike e rritjes suajpor me rritjen bëhemi selektivë dhe i afrohemi investimeve të blerjeje për libra më profesionalë apo më akademik. Natyrshëm na duhet të ekonomizojmë hapsirat fizike duke i dhënë prioritet të reja bashkëshoqëruese, ndërkohë që ato të mëparshmit që mbartin vë vetvete kujtimet e një kohe, do ti duhet ti mendojmë një strehëz të re, që shpesh here e kemi, por herë të tjera na çon ose në vendime të nxituar duke i flakur, por edhe duke reflektuar. Paprtitmas e gjejmë veten përpara kështjellës së tyre që duket sikur po shembet me dilemen:

*"Çtë bëjmë me to?"*

Zëri i ndërgjegjes më përgjigjet: "Ndërkohë që shumë fëmijë përfetojnë krizën e të mos gjeturit të librave për fëmijë në bibliotekat e shkollave të tyre, ty nuk të trishton ky fakt? – Jo i përgjigjem, më shumë më gëzon ky fenomen.

Dhe e dini pse? Sepse ende ka shpresë, ka ende fëmijë që duan të lexojnë e të shfletojnë, ndërkohë që trokasin në dyert e bibliotekave dhe gjejnë po ato libra që kanë lexuar dhe rilexuar, ndonëse paradoksialisht botohen e

botohen por as autorët vetë nuk kujtohen ti dhurojnë. Nisur nga ky trishtim i bashkëndarë me mjaft kolege që punojnë në këto shkolla, të cilat me dhimbje e tregonin duke i shtuar faktin që për ti ushqyer dëshirën për leximin u sillnin edhe libra nga shtëpitë e tyre.

Ky akt fisnik i tyre na bëri të reflektojmë si staf për të ndërmarrë një nismë të re me vlerë të jashtëzakonshme për Universitetin tonë: "Dhuro librat e fëmijërisë suaj." Kjo fushatë në vetvete ka për qëllim të mbështesë shkollat dhe bibliotekat e qyteteve apo fshatrave që nuk kanë mundësi financiare për të pasuruar fondin e tyre bibliotekar.

Shumë prej këtyre institucioneve vuajnë mungesën e literaturës elementare për fëmijë, dhe pasojat janë të dukshme: nxënës të cilët rriten pa dashurinë për leximin, pa akses në libra që zhvillojnë imagjinatën dhe pa mundësinë për të eksploruar botën përtej kufijve të realitetit të tyre. **Çdo libër që dhurohet është më shumë se një objekt.**

Është një dritare që hapet, një zë që flet, një dorë që udhëzon një fëmijë drejt dijes dhe krijimtarisë. Janë pikërisht librat e fëmijërisë ata që kanë formësuar kujtimet tona më të bukura, që na kanë mësuar të ëndërrojmë, të besojmë, të kuptojmë dhe të ndjejmë.

Duke i dhuruar këto libra, ne nuk po heqim dorë nga kujtimet tona, por po u japim jetë të re në duart e dikujt tjetër që ka nevojë për to. Kjo nismë është më shumë se një akt solidariteti – është një investim në të ardhmen.

Fëmijët që rriten me libra kanë më shumë gjasa të zhvillojnë aftësi kritike, të jenë empatikë dhe të kenë sukses në jetën akademike dhe shoqërore. Në këtë mënyrë, çdo libër i dhuruar është një hap drejt një shoqërie më të arsimuar dhe të barabartë.


Prandaj, le të hapim raftet tona, le të nxjerrim librat që dikur na kanë lumturuar dhe le t'i japim mundësinë dikujt tjetër të ndjejë të njëjtën magji. Nëse çdo lexues dhuron vetëm një libër të fëmijërisë së tij, do të krijojmë një pasuri të paçmuar për gjeneratat që vijnë.

Sepse librat e fëmijërisë nuk janë thjesht kujtime – janë udhërrëfyes për të ardhmen.

Faleminderit të gjithë studentëve dhe stafit që i janë bashkuar kësaj nisme, të cilët kanë qenë të shumtë. Shumë prej tyre kanë preferuar të mbeten anonimë. Jemi në pritje të prurjeve të reja.

Mos harro!

Dje ishte edhe ti fëmijë, ndërsa sot je një hap larg të qenurit mjek, farmacist, infermier, fizioterapist, arkitekt, ekonomist, stomatolog.



# TAKIMET E ARDHSHME



CATHOLIC UNIVERSITY  
OUR LADY OF GOOD COUNSEL



## Roots of War and Establishment of a Lasting Peace

10<sup>th</sup> EDITION

# SUMMER SCHOOL

September 2-9, 2025

(one week / 35 hours)

The European Center of Peace Science, Integration and Cooperation (CESPIC) of the Catholic University "Our Lady of Good Counsel" organizes the 10th Summer School "Roots of War and Establishment of a Lasting Peace". The Summer school aims to provide a group of international graduate students with scientific pillars about the roots of war, peace and issues in peacebuilding.

The program is interdisciplinary involving disciplines such as economics, political science and international relations.

The Summer school is designed for graduate students with a strong interest in the scientific study of Peace that are either willing to proceed to advanced graduate studies or to become future practitioners in the field of international relations and peacebuilding. In order to favor also a fruitful and open dialogue with the faculty a small group of students will be selected.

The faculty is composed of world-class scholars in the field.



UNIVERSITÀ CATTOLICA  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



Progetto di Ricerca e Sviluppo AKKSHI 2025  
coordinato da:  
PhD. Arch. ANDIA GUGA  
Dipartimento di Architettura  
Facoltà di Scienze Applicate

PRESENTAZIONE PROGETTO

MONITORAGGIO STRUTTURALE DELLA GRANDE SALA DEI  
CONCERTI DELL'UNIVERSITA' DELLE ARTI DI TIRANA  
INNOVAZIONE TECNOLOGICA PER LA SALVAGUARDIA DEL  
PATRIMONIO CULTURALE ALBANESE



15/10  
2025

ORE 10.00

Grande Sala dei  
Concerti  
Università delle Arti  
di Tirana

[meet.google.com/pui-jaxw-omu](https://meet.google.com/pui-jaxw-omu)



UNIVERSITÀ  
DEGLI STUDI  
FIRENZE

DIDA  
DIPARTIMENTO  
DI ARCHITETTURA



TECNOPOLO  
D'ALEMA  
A HOME FOR YOUR  
BUSINESS



WEST  
ARCHITETTURA



COMITECH



MG AD

**Ta lexosh verën në një mënyrë tjetër**

**Tregime për t'i marrë me vete nën çadër (ose kudo që dëshiron ti!)**



Kopjet e librit gjenden në Bibliotekën "fratel Paolo Ruatti" pranë Universitetit Katolik ZKM, Tiranë.

BICENTENARIO  
Giubileo  
giovani



# Pellegrini della Carità

23 luglio - 3 agosto 2025

Cantù - Bovisio Masciago - Milano - Saronno - Roma

24  
LUGLIO  
BOVISIO  
MASCIAGO  
1825-2025

BICENTENARIO  
DELLA  
NASCITA  
DI LUIGI MONTI



*il paese  
rinasce*

## Programma

**18:30**  
Santa Messa  
Parrocchia S. Pancrazio

**19:30**  
Apericena con Musica  
Piazza Anselmo IV

**21:00**  
Concerto Musical  
sul Beato Luigi Maria Monti,  
La Campanella  
Cinema & Teatro

info: [camminomontiano@gmail.com](mailto:camminomontiano@gmail.com)

La compagnia  
teatro instabile  
presenta

# Così... per amore Musical

In 2 tempi  
di Aleandro Paritanti  
& Filippo Mussi

Musica live e arrangiamenti  
Sax Ensemble  
Light design Live  
Video Marco Angelica



📅 24 luglio 2025

📍 La Campanella  
Cinema & Teatro,  
Bovisio Masciago

🕒 21:00

info: [camminomontiano@gmail.com](mailto:camminomontiano@gmail.com)

In occasione del Bicentenario  
della Nascita di Luigi Monti



"QUI È  
COMINCIATO  
TUTTO"

Sabato 20 settembre 2025 ore 21:00

📍 Sala di Comunità La Campanella, Piazza Anselmo IV, Bovisio Masciago

# Magia della Sabbia

con la partecipazione di

STEFANIA  
BRUNO

Sand Artist

La storia  
di Luigi Monti

Ingresso  
Libero

Per contatti

[camminomontiano@gmail.com](mailto:camminomontiano@gmail.com)